Kronikë

# Qëlloi me automatik në ajër, kapet autori 17-vjeçar në Gjirokastër, i gjendet dhe një armë tjetër në banesë

*Një 17-vjeçar me iniciale P.Dh., nga fshati Gjat ra në prangat e policisë pasi gjatë mbrëmjes së djeshme ka qëlluar në ajër me një armë zjarri të llojit automatik.*



*Armët e sekuestruara*

Redaksia
16 Qershor, 14:04 | **Përditesimi i fundit: 16 Qershor, 14:16**

**GJIROKASTËR**- Një 17-vjeçar me iniciale P.Dh., nga fshati Gjat ra në prangat e policisë pasi gjatë mbrëmjes së djeshme ka qëlluar në ajër me një armë zjarri të llojit automatik.

Policia e arrestoi brenda pak orësh 17-vjeçarin, pas njoftimit të marrë se në fshatin Gjat, Lunxhëri ishin dëgjuar të shtëna.



LEXO EDHE:
**Kamioni del nga rruga dhe bie në një zonë të pyllëzuar në Gjirokastër, një i plagosur rëndë**

Pasi ka qëlluar, 17-vjeçari ka fshehur armën e zjarrit dhe është larguar.

Policia ka gjetur dhe sekuestruar armën e zjarrit, me të cilën dyshohet se i riu ka qëlluar në ajër, si dhe dy krehra.

Po ashtu, nga kontrolli i ushtruar në banesën e tij u gjet edhe një armë sportive, pa leje.

17-vjeçari akuzohet për veprat penale:"Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe municionit", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive" dhe "Prishja e qetësisë publike".

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

S.C/Shqiptarja.com

**TAG:** policia | arme pa leje | Gjirokaster

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**Rritja e çmimeve, a duhet të ketë një tjetër Paketë të Rezistencës Sociale?**

PO | JO | NUK E DI




RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

## Lajme të tjera

Kronikë

'Të dehur dhe pa patentë', arrestohen 5 shoferë në Fier
16 Qershor, 12:53

Kronikë

Merr flakë makina në Qafën e Muzinës, radhë e gjatë automjetesh në aksin Gjirokastër-Sarandë (VIDEO)
16 Qershor, 09:35

Kronikë

Po transportonte 4 emigrantë të paligjshëm kundrejt parave, në kërkim 21-vjeçari në Gjirokastër
15 Qershor, 10:57

Politikë

Zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Zgjeruar e Bashkisë Përmet, dy kandidatët prezantojnë platformat për drejtues të degës së PS-së në Përmet
14 Qershor, 19:48

Politikë

Zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Zgjeruar e Bashkisë Përmet! Dy kandidatët prezantojnë platformat për drejtues të degës
14 Qershor, 16:57

Kronikë

Po transportonte 26 emigrantë të paligjshëm me furgon dhe kundrejt parave, në pranga 24-vjeçari në Tepelenë (EMRI)
14 Qershor, 11:40

Politikë

Më 2 korrik hapet aksi Kardhiq-Delvinë, Rama publikon pamjet e punimeve: Janë drejt përfundimit! Do të lehtësohet aksesi drejt Sarandës
13 Qershor, 14:54

Kronikë

Qarkullonte me armë zjarri në brez, arrestohet 33-vjeçari në Vlorë! Në 2016-tën plagosi një 26-vjeçare
12 Qershor, 12:20

Kultura

Inaugurohet teatri 'Zihni Sako' në Gjirokastër! Premierë 'Vdekja aksidentale e një revolucionari', regjisori italian: Flasim gjuhën e artit! Artistët: Publik i veçantë
11 Qershor, 22:05

Kronikë

Goditën me levë policin ditën e djeshme në Gjirokastër, arrestohen 2 autorët e dyshuar në kërkim dy të tjerët
10 Qershor, 13:57

Kronikë

Transportonte 4 emigrantë të paligjshëm, arrestohet i riu në Gjirokastër
10 Qershor, 13:33

Kronikë

I vranë burrin në 1997, kanoset që të mos shkojë në gjyq! Policia shpall në kërkim 56-vjeçarin (EMRI)
10 Qershor, 12:58



© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje